

VENDIM
Nr.666, datë 21.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA LIBOHOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Libohovë, të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 5 (pesë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Libohovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror MMPAU Bashkia: Libohovë										
Nr. rend.	Numri i pasurisë sipas inventarit	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore EPK)	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësitë administrative	Institucioni, enti përdoues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	125	EK Libohove	Brinja e faqes se gjere	14	K.Verore	71	Kullote	MMPAU	Bash.Libohovë	
2	126	"	Hallazmata	15	K.Verore	112	Kullote	"	"	
3	127	"	Guva e zeze-Revani	16	K.Dimerore	100	Kullote	"	"	
4	128	"	Revani	17	K.Dimerore	82	Kullote	"	"	
5	129	"	Kathizma	18	K.Verore	230	Kullote	"	"	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
125-129	Pyll + sip. të tjera	Në pronësi